

## STATUTI

### I

#### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “MONO ENERGY SERVICES, CONSULTING & RESEARCH” SH.P.K

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe të akteve të tjera nënligjore, sot me datë 13 Mars 2021, formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nga ortak themelues si vijon:

**Z. Viktor Aliaj**, atësia **Fran**, lindur më **27.09.1961**, në **Pukë** dhe banues në Tiranë në adresën **“Rr. Siri Kodra, Nd. 7, Sh. 3, Ap. 13, 1017”**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe mbajtës i pasaportës me numër **BF4186867** dhe numër personal **G10927096P**.

### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Mono Energy Services, Consulting & Research” Sh.p.k.**

##### Neni 2


##### Forma juridike

Shoqëria **“Mono Energy Services, Consulting & Research” Sh.p.k.** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”) e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Themeluesi i Shoqërisë në këtë sipërmarrje ka derdhur kapitalin e shoqërisë, me qëllim që të përfitojë të ardhura që mund të vijnë nga veprimtaria private si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin fillestar.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjestim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.




1

### **Neni 3 Selia**

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Adresa: "Rr. Siri Kodra, Nd. 7, Sh. 3, Ap. 13, 1017". Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **Neni 4 Objekti**

1. Ofrimi i shërbimeve energjetike, përfshirë aktivitetin e shërbimeve financiar për përmirësimin e efikasitetit të energjisë përmes kontraktimit të performancës energjetike me terma dhe kushte të negociuara lirisht midis palëve.
2. Realizimin e Auditimeve të Energjisë në sektorin e ndërtesave për ndërtesat publike dhe private, në sektorin e ndriçimit publik dhe privat, në sektorin e transportit, në sektorin bujqësor si dhe në sektorin industrial për ndërmarrjet industriale të vogla, të mesme dhe të mëdha. Të mbikqyrë realizimin e masave të efikasitetit të energjisë që implementohen në të gjithë sektorët e mësipërm, bazuar në vlerësimet e auditimeve energjetike.
3. Oponencë teknike për rezultatet e auditimeve të energjisë në të gjithë sektorët e sipërpërmendur.
4. Import-eksport i makinerive, pajisjeve dhe instrumentave që përdoren në sektorin e ndërtesave, sektorin industrial, sektorin e transportit, sektorin e bujqësisë dhe ushqimorë. Mirembajtje, servise, kalibrime të pajisjeve të mësipërme. Shitje dhe shërbim pompash të llojeve të ndryshme. Shitje dhe shërbim pjesë këmbimi për makineri, pjesë dhe instrumenta të ndryshëm; Përveç të tjerave shoqëria mund të kryejë projektimin, zhvillimin, kërkimin dhe instalimin e impianteve dhe instrumentave të ndryshëm në secilin prej sektorëve të sipërpërmendur.
5. Dhënia me qera e pjesëve që shoqëria zotëron.
6. Pjesëmarrje në tendera kombëtare dhe ndërkombëtare dhe procedura të tjera të këtij lloji.
7. Të realizojë kurse trajnimi, seminarë dhe konferenca në nivel vendi dhe nivel rajonal në lidhje me të gjitha aspektet e energjisë, efikasitetit të energjisë, auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri, aspekte të menaxhimit të energjisë, vlerësimin e skenarëve të ndryshëm të reduktimit të gazeve me efekt serra, etj.
8. Realizimin e studimeve të plota teknike-ekonomike financiare-mjedisore për shfrytëzimin e burimeve energjetike (hidroenergjia, naftë dhe nënprodukte naftë, gaz natyror, qymyr, biomasa, energji diellore, energji ere) për prodhimin e energjisë elektrike dhe energjisë termike.




2

9. Të trajnojë audituesit e energjisë në ndërtesa, në industri dhe në transport mbi mënyrën e përdorimit të paisjeve që nevojiten për realizimin e auditimeve energjetike, hartimin e raporteve përkatëse, gjenerimin e Certifikatave të Performancës së Energjisë, hartimin e planeve të veprimit në nivel institucional, vendor dhe kombëtar si dhe të gjitha proceset e tjera që parashikohen nga detyrimet ligjore në fuqi.
10. Të krijojë data base (sistem të dhënash) energjetike dhe mjedisore në nivel ndërmarrje, institucioni, vendi dhe nivel rajonal.
11. Të kryejë konsulencë teknike dhe të realizojë studime në lidhje me politikën fiskale për burimet dhe komoditetet energjetike.
12. Të kryejë konsulencë teknike, të monitorojë zbatimin e ligjit për Performancën e Energjisë në Ndërtesa dhe normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së energjisë në ndërtesa në të gjitha Komunat, Bashkitë dhe Qarqet e vendit.
13. Të realizojë implementimin e masave të efikasitetit të energjisë në bashkëpunim me palë të tjera në ndërtesat publike dhe private, ndriçim public dhe privat, ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha industriale dhe tregtare bazuar në vlerësimet e auditimeve energjetike.
14. Realizon kërkime të karakteristik shkencor të të gjithë elementëve që lidhen me aspektin energjetik dhe përgatit raporte, baza të dhënash, etj, sipas burimit të informacionit të përfutur.
15. Realizon studime zbatueshmërie (fizibiliteti) për projekte të ndryshme që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt ose përfshijnë efikasitetin e energjisë, burimet e rinovueshme të energjisë si dhe reduktimin e gazeve me efekt serrë.
16. Realizimin e botimeve të ndryshme në lidhje me të gjitha çështjet e sipërpërmendura.
17. Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të saj mund të marrë përsipër si direkt ashtu dhe indirekt, pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta në fushat e sipërpërmendura si me shoqëri shqiptare ashtu edhe me shoqëri të huaja që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me objektin e saj.
18. Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektivit të aktivitetit të saj.

## **Neni 5** **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.



3

**KREU II**  
**KAPITALI I SHOQERISE**

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke dhe eshte i perbere nga 1 kuote.

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortakët e shoqerise perkatesisht:

**Z. Viktor Aliaj**, zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100 000 Leke, qe perbejne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise. Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/ te paluajtshme apo te drejta). Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte ti kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda tre vjeteve nga casti i cenimit.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashigimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.


Ky statut kushtezon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqerise dhe te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo te ortakeve te tjere, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas legjislacionit ne fuqi.

Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashigimie.



### KREU III

## ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.


Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 9

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve;
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim në statut duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 10 Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administratori i shoqërisë është **Z. Viktor Aliaj** me numër personal **G10927096P**, i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën kombëtare të Biznesit.

### **Neni 11 Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbrojtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatiti dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sikurse parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur:

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim dhe

kur Shoqëria, brenda 2 (dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind e asateve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori e përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publikë dhe/ osë privatë, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.


## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

1. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administrator detyrohet:




7

- a) të kryej detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprmtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendimi;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ato të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kajojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asmblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR - EKSPERTËT**

**Neni 16**  
**Viti financiar**

Viti financiar i Shoqrisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**  
**Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, sikurse edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 18**  
**Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autoruar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Neni 19**  
**Të ardhurat neto**

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiscal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi ortakëve.



## KREU V

### PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

#### Neni 20

##### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prisha e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqrive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 21

##### Likuiduesi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet spas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryej veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përvaktimet e ligjit. Likuiduesi i nënshtrohet mbikqyrjes së ortakut dhe administratorit.

#### Neni 22

##### Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar rradhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqrisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduese përgatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite, miratohen nga ortakët e tjerë ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme.

### **Neni 23** **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

### **Neni 24** **Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqërie tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky process quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila klohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky process quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

### **Neni 25** **Ndarja**

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, duke transferuat të gjitha aktivet e pasivet e veta nën favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
- b) bërjen e aksionarëve/ ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit

## **Neni 26 Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionere. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

## **Neni 27 Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 28 Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

## **Neni 29 Dispozita përfundimtare**

Ky statut u redaktua në 4 (katër) ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqip dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare “**Mono Energy Services, Consulting & Research**” Sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre.



12


ORTAKËT

E

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“MONO ENERGY SERVICES, CONSULTING & RESEARCH” SH.P.K

Viktor Aliaj

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke, positioned below the name 'Viktor Aliaj'.

datë 13.03.2024